



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM DIBËR

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.44, datë 02.04.2024

PËR

**NORMIMIN E DISA RREGULLAVE PËR QARKULLIMIN E SHKRESAVE,
AKTEVE DHE MATERIALEVE HETIMORE NË PROKURORINË PRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DIBËR**

Unë **Abaz MUÇA**, Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në mbështetje të neneve 42, 46 dhe 52 të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 4 të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”¹, udhëzimit të përgjithshëm nr.2, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori” dhe udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar me udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.16, datë 14.12.2020 “Për disa ndryshime në udhëzimin e përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm””, me qëllim:

- disiplinimin e veprimeve procedurale dhe administrative për qarkullimin e shkresave, akteve dhe materialeve hetimore,

¹ Miratuar me urdhërin nr.37, datë 25.03.2024, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

- përcaktimin e rregullave të sakta dhe afateve të qarta për qarkullimin e shkresave, akteve dhe materialeve hetimore,
- forcimin e rregullshmërisë administrative në qarkullimin e shkresave, akteve dhe materialeve hetimore nëpër të gjitha hallkat e prokurorisë,
- evidentimin e personit përgjegjës në rast situatë problematike,

U D H Ë Z O J:

1. Për të garantuar transparencën e marrëdhënieve dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga ligji nr.97, i vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet e nxjerra në zbatim të tij, qarkullimi i shkresave, akteve dhe materialeve hetimore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër do të kryhet përmes protokollimit në regjistrin e komunikimeve të brendshme, sipas modelit lidhja nr.1 bashkëlidhur udhëzimit nr.12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar me udhëzimin nr.16, datë 14.12.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për disa ndryshime në udhëzimin e përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm””, në zbatim të këtij udhëzimi.
2. Nëpunësi i regjistrin, pasi protokollon në regjistër shkresën, aktin ose materialin hetimor, pas siglimit të Drejtuesit të Prokurorisë, ia kalon menjëherë prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore ose punonjësit administrativ të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, kundrejt firmës.
3. Prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore ose punonjësit administrativ të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër kanë detyrimin që çdo shkresë, akt ose material hetimor, që do qarkullojë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ta dorëzojnë kundrejt firmës tek nëpunësi që mban regjistrin e komunikimeve të brendshme.
4. Nëpunësi i regjistrin të komunikimeve të brendshme në prokurori mban përgjegjësi për rregullshmërinë mbajtjes së këtij regjistri.
5. Të njihen me këtë urdhër të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, sekretarët dhe administrata e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
6. Mosrespektimi i këtij udhëzimi përbën shkelje të natyrës disiplinore.

7. Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe depozitimit në sekretari dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

DREJTUESI

ABAZ MUÇA

